

VENDIM
Nr. 205, datë 18.12.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGJI ASHTA” SHPK, NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “d”; 5, pika 1, germa “d”; 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.12.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Shoqëria “Energji Ashta” sh.p.k., me shkresën nr. 714 prot., datë 2.11.2017, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

Shoqëria “Energji Ashta” sh.p.k., me shkresën nr. 714/2 prot., datë 12.12.2017 ka paraqitur dokumentacionin shtesë në mbështetje të kërkesës për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

Aplikimi i shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, germat “a”, “b”, “c” dhe “f”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me nenin 9, pika 2 dhe pika 3, germa “a”, do të njoftohet subjekti, që në bazë të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti